



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 28 paragrafi 2 pika (l) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e konform Shkresës së Ministrisë së Financave, Punën dhe Transfereve, Nr. 386-1/2022 të datës 23.03.2022, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.04.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12176

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi, 01-Nr-016-12176, i datës 28.02.2022, për pagesën e shujtës për të gjithë nëpunësit në administratën të Komunës së Suharekës.

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-25502
Më datë 28.04.2022



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr.ec Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenin 29 dhe 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.04.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153, të datës 28.02.2022

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimit, 01-Nr-016-12153 i datës 28.02.2022 i komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor që do të ndërtohet në pronësi të Komunës nga **Bashkim Sali HOXHAI** dhe z. **Sami Dervish ELSHANI**.

Neni 2

Pika 1.3, e Nenit 1, të vendimit bazike ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

Laureta TAFAJ-----Përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës, emërohet anëtare e komisionit të lartcekur, pasi që **Festë KABASHI** ka dhënë dorëheqje.

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-016-12153, të datës 28.02.2022, mbesin të pa ndryshuara.


Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-25493
Me datë 28.04.2022



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-28/2008, dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-27/2008, nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.04.2022, miraton këtë:

V E N D I M

Për ri-alokimin e mjeteve brenda fondit burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2022 nga projektet kapitale

Neni 1

1.1 Në bazë të Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-066 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2022 nga Rezervat e projekteve kapitale që duhet të buxhetohen në projekte kapitale është shuma prej 624,989.00€ (510,000.00+114,989.00), e që në total i bie shuma prej =624,989.00€, si rezervë e cila duhet të kalojë në kategorinë aktive të projekteve kapitale.

1.2 Shuma e lartshënuar do të transferohet- alokohet në këto projekte kapitale të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret sipas Udhëzimit Administrativ Nr.04/2019 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale e që tani konsiderojmë se janë plotësuar kërkesat e Udhëzimeve Administrative në fjalë.

Neni 2

Lista e projekteve kapitale që kalojnë nga Rezervat në projekte kapitale për vitin fiskal 2022 janë si më poshtë;

Programi	Kodi i Programit	Kodi i Projektit	Emërtimi I Projektit	10-BKK 2022	21-THV 2022	Totali 2022
624180-Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia						
180120-Infrastruktura Rrugore-Suhareke						
180	18012	52024	Projektet me bashkëfinancim	100,000.00	45,000.00	145,000.00
Totali -Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia				100,000.00	45,000.00	145,000.00



624470-Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural						
470120-Bujqësia -Suharekë						
470	47012	Projekt I Ri	Ndërtimi dhe rregullimi i Kolektorit në rrugën "Skënderbeu"-Suharekë	410,000.00		410,000.00
470	47012	Projekt I RI	Projektet me bashkëfinancim		59,989.00	59,989.00
Totali -Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural				410,000.00	59,989.00	469,989.00
624166- Inspeksioni						
16623- Inspeksioni						
166	16623	Projekt I Ri	Ndërtimi dhe rregullimi i Kolektorit në rrugën "Skënderbeu"-Suharekë		10,000.00	10,000.00
T OTALI KOMUNAL :				510,000.00	114,989.00	624,989.00

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.



KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-25505
Më datë 28.04.2022



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr. ec Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019, e konform nenit 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 15 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 dhe sipas kërkesës së MAPL-së Nr. 020-93/3 të datës 08.02.2022, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 28.04.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, për parcelat P-72116046-02785/81, P-72116046-02785/82, P-72116046-02785/83 dhe P-72116046-02785/84, si pas vendimit paraprak 01-Nr-016-13801, të datës 26.02.2021.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbehet prej 5, (pesë) anëtarëve dhe do të jetë kjo përbërje:

- 2.1 Driton MALIQAJ-----AAK---përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
- 2.2 Mevlude KABASHI----PDK---përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
- 2.3 Armend KRASNIQI-----përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.4 Visar KUQI-----përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.5 Suzana GASHI-----përfaqësuese nga sektori jo qeveritar

Neni 3

Komisioni do të kryen punën pas marrjes së vendimit paraprak nga Kuvendi i Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësit e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, janë të përcaktuara me dispozita ligjore të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-10/2019”, komisioni ka autoritet, mandat dhe kompetencë të bëjë njoftimin publikë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, kushtet dhe kriteret specifik gjatë ankandit publik dhe shprehjes së interesit.



Neni 5

Obligohet zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, ti zhvillojnë procedurat e ankandit publikë, shprehjes së interesit dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 6

6.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohet nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Suharekës.

6.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 7

Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 8

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 9

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-016-6355, i datës 28.01.2022, për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 410-25511
Me datë 28.04.2022



Kryesuesi i Kuvendit

[Signature]
Mr.ec Bexhet KUÇI





Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 27, 28 dhe 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 28.04.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për ta përcjell procesin e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit të “Hartës Zonale të Komunës së Suharekës” për periudhën 2022-2030, me këtë përbërje:

- 1.1. Afërdita MAMAJ-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
- 1.2. Kushtrim KUÇI-----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.3. Sheqerije ZYRAPI---përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.4. Liridon FANDAJ----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.5. Jehona RRAFSHI----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.6. Herolind LIMAJ-----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që ta përcjell procesin e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit të “Hartës Zonale të Komunës së Suharekës” për periudhën 2022-2030 dhe t’i informojnë të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës për mbarëvajtjen e procesit të shqyrtimit publik të projekt-dokumentit të “Hartës Zonale të Komunës së Suharekës” për periudhën 2022-2030.

Neni 3

Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat procesi i shqyrtimit publik të projekt-dokumentit të “Hartës Zonale të Komunës së Suharekës” për periudhën 2022-2030.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 410-25529
Më datë 28.04.2022



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI



Duke u bazuar në nenin 12 dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenin 11, 27, 28 dhe 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të Vendimit, 01-Nr-105, të datës 26.05.2003, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 28.04.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit

Neni 1

Emërohet komisioni për pranimin dhe nominimin e propozimeve që vijën nga ana e qytetarëve, institucioneve, shoqatave, kryesive të fshatrave për dhënien e shpërblimeve "Emblema e artë", "Skënderbeu" dhe mirënjohjes "13 Qershori" me këtë përbërje:

- 1.1. Bexhet KUÇI-----kryesues
- 1.2. Bulza KUÇI-----anëtare
- 1.3. Bajram BASHA-----anëtar
- 1.4. Festë KABASHI-----anëtare
- 1.5. Jehona RAFSHI-----anëtare
- 1.6. Adem BYTYÇI-----anëtar
- 1.7. Destan ZEKOLLI-----anëtar

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të bëjë shqyrtimin e propozimeve që vijnë nga qytetarët, institucionet, shoqatat, kryesitë e fshatrave, prej individëve, etj, bazuar në vendimet e Kuvendit të Komunës për ndarjen e shpërblimit "Emblema e artë", shpërblimit "Skënderbeu" dhe mirënjohjes, "13 Qershori" të datës 26.05.2003 dhe pas kryerjes së detyrës propozimet i dorëzojnë tek Kuvendi i Komunës për miratim.

Neni 3

3.1 Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-~~016~~-410-25496
Më datë 28.04.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Mr. Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, e në mbështetje të nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe konform nenit 6, të Rregullores 01-Nr-16-7879, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Suharekës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2022, miraton këtë:

V E N D I M
Për themelimin e komisionit

Neni 1

- 1.1 Themelohet komisioni për të udhëhequr dhe koordinuar procesin e zgjedhjes së këshillave lokale në tërë territorin e Komunës së Suharekës.
- 1.2 Komisioni do të përbehet prej 7, (shtatë) anëtarëve dhe do të ketë përbërje:
 - 1.2.1 Saranda BAJRAKTARI-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.2 Alban BERISHA-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.3 Dardan BERISHA-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.4 Liridon FANDAJ-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.5 Kymete BAJRAKTARI-----përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës
 - 1.2.6 Albulena KOKOLLARI-----përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës
 - 1.2.7 Përfaqësuesi/ja nga secili fshat, vendbanim apo lagje ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.

Neni 2

- 2.1 Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjë udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave lokal në fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunës e Suharekës, konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe Rregullores 01-Nr-16-7879, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Suharekës.
- 2.2 Komisioni pas përfundimit të të gjitha proceduarve për zgjedhjen e këshillave lokal ka për obligim që të raporton para Kuvendit të Komunës së Suharekës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të këshillave lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në tërë territorin e Komunës së Suharekës.



Neni 3

3.1 Mandati i anëtareve të Komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-410-25500
Me datë 28.04.2022



Kryesuesi Kuvendit
[Signature]
Mr. **Bexhet KUÇI**





Drejtoria Komunale për Arsim

05Nr. 553

Datë: 16.05.2022

VENDIM

Për përzgjedhjen e kandidatëve në bazë të pikëve të fituara në testin me shkrim dhe Intervistën me gojë, sipas konkursit me nr. të protokollit 05Nr.381, të datës 30.03.2022, sipas listave të më poshtme:

1.

1	Pozita sipas konkursit: Një mësimdhënës/e			Pikët
Nr.	Emri dhe mbiemri	Aplikon në lëndën	Aplikon në shkollën	
1	Valbona Fondaj	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	SHFMU" Dëshmorët e Tivarit" Peqan	153.7
2	Albulena Berisha Hoxha	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	SHFMU" Dëshmorët e Tivarit" Peqan	139.6
3	Betina Elezi	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	SHFMU" Dëshmorët e Tivarit" Peqan	134.3
4	Arbresha Maliqaj	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	SHFMU" Dëshmorët e Tivarit" Peqan	125

2.

2	Pozita sipas konkursit: Një mësimdhënës/e			Pikët
Nr.	Emri dhe mbiemri	Aplikon në pozitën	Aplikon në shkollën	
1	Endrit Sylaj	Histori - Edukatë Qytetare	SHFMU" Sadri Duhla" Duhël	148.6
2	Agron Blea	Histori - Edukatë Qytetare	SHFMU" Sadri Duhla" Duhël	144



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



3.

3	Pozita sipas konkursit: Një (1) Punëtor/e teknik/ndihmës - Rishpallje			Pikët
Nr.	Emri dhe mbiemri	Aplikon në pozitën	Aplikon në shkollën	
2	Flurim Bajraktari	Teknik/Ndihmës	SHFMU "Dituria" Samadrexhë	132.6

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa në nivel komune, në afat prej 8 (tetë) ditësh nga publikimi i rezultateve në faqen zyrtare të komunës dhe në tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Komisioni

